

Tirane me 25 Mars 2002



## AKT THEMELIMI

### Une :

Paride Boschetti, i biri i Nazzareno-s ,dhe i Anna-es, lindur ne Rimini me 05.11.1963 dhe banues ne S.Agata Feltrie (PS) Itali me nr. pasaporte 159604 V me zotesi te plote juridike per te vepruar, vendosa te themeloj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "GEOSAT GROUP " sh.p.k. ne fushen e " Projekttime dhe ndertime , topografi, dhe kerkime gjeologjike, si dhe tregtim materjalesh ndertimi " sipas licenses perkatese. Per kete qellim perpilova edhe dokumentacionin bashkangjitur si emerimin dhe licensen e drejtuesit teknik , statutin ,kete akt themelimi dhe mbi kete baze ju drejtohem ju si gjykate kopetente per sa me poshte:

Kerkoj per te regjistruar si person juridik shoqerine "GEOSAT GROUP " sh.p.k. ne Regjistrin Tregtar prane asaj Gjykate.

Shoqerija qe une vendosa te themeloj do te kete Formen e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, me ortak te vetem Z. Paride Boschetti,

Emertimi i shoqerise eshte " GEOSAT GROUP " sh.p.k.

Objekti i shoqerise eshte : " Projekttime dhe ndertime , topografi, dhe kerkime gjeologjike, si dhe tregtim materjalesh ndertimi " sipas licenses perkatese.

Selia e shoqerise ndodhet ne Rr. DURRESIT , ne kryqezimin e quajtur Zogu i Zi" Tirane.

Kohezgjatja e shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe prej 20 vjetesh duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Gjykate.

Kapitali Themeltar eshte 100.000 leke. Ai eshte ndare ne 100 pjese sejcila, te renditura sipas numurit te serise nga 1 deri 1.000.

Administrator i Shoqerise eshte Z. Paride Boschetti, me identitetin e mesiperm.

Kontributet i takojne ortakut te vetem ne masen 100 % .

Organ i vetem drejtues eshte ortakut i vetem dhe administratori i shoqerise : Z. Paride Boschetti.

Kjo shoqeri ka stemen e saj , vulen dhe llogarine rjedhese te vecante , qe disponohen nga ortakut i vetem dhe administratori i saj.

Kjo Shoqeri fiton personalitetin e saj juridik qe nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar.

Ky Akt Themelimi u hartua ne Tirane sot me date 25. 03. 2002 nga une ortakut i vetem Paride Boschetti.

THEMELIMI

Paride Boschetti



# STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"GEOSAT GROUP" sh.p.k.

## AUTORSIJA:

Une Paride Boschetti, i biri i Nazzareno- s ,dhe i Anna-es, lindur ne Rimini me 05.11.1963 dhe banues ne S.Agata Feltrie (PS) Itali me nr. pasaporte 159604 V me zotesi te plote juridike per te vepruar. , vendosa te krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "GEOSAT GROUP " sh.p.k. gje per te cilen perpilova edhe kete Statut te saj.

## KREU I

### **FORMA, EMERTIMI I SHOQERISE OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA**

Neni 1

#### Forma e Shoqerise dhe baza ligjore e krijimit te saj.

Krijohet nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, dhe me ortak te vetem, e cila e ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, si Kodin Civil, Kodin e Procedures Civile, Ligjet me Nr.7632 dt. 04.11.1992 "Per Dispozitat qe Rregullojne Pjesen e Pare te Kodit Tregtar " ai me Nr.7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare", Ligja nr. 7667 dt.28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar". aktet e tjera ligjore qe do jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise si dhe me dispozitat e ketij Statuti qe do ti bashkangjitet Vendimit te Gjykates.

Neni 2

### **EMERTIMI I SHOQERISE**

Emertimi i shoqerise eshte " GEOSAT GROUP " sh.p.k.

Neni 3

### **OBJEKTI I SHOQERISE**

Objekti i shoqerise eshte : "Projektme dhe ndertime ,topografi dhe kerkime gjeologjike, si dhe tregtim materjalesh ndertimi ne pershtatje me kete objekt aktiviteti".

Pervec veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine sipermarese te shoqerise, do te hyje cdo veprimtari tjeter industriale, tregtare financiare dhe ndertimi qe do te konsiderohen nga ortaku i vetem i nevojshme dhe e pershtateshme per arritjen e objektit te shoqerise. Per shtimin e objektit do te veprohet ne konformitet me ligjen ne fuqi.

Neni 4

## **SELIA E SHOQERISE**

Selia e shoqerise ndodhet ne Rr. DURRESIT , ne kryqezimin e quajtur Zogu i Zi" Tirane.

Neni 5

## **KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe prej 20 vjetesh duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Gjykate.

Kjo periudhe mund te zgjatet tej afatit ose te shkurtohet kur shoqeria priset para kohe.

## **KREU II**

### **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR DHE ADMINISTRATORI**

Neni 6

#### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali Themeltar eshte 100.000 leke. Ai eshte ndare ne 100 pjese sejcila, te renditura sipas numurit te serise nga 1 deri 1.000.

Eshte e drejta e ortakut te vetem te zmadhoje ose pakesoje Kapitalin Themeltar. Kapitali Themeltar nuk mund te zvogelohet nen nivelin e sipertreguar.

Neni 7

Kapitali Themeltar eshte lirisht i transferueshem ne ruge trashegimie, ndermjet bashkshorteve dhe paraardhesve e pasardhesve.

Ne kete rast perfituesit behen ortake te shoqerise ne proporcion me pjesen e kapitalit qe u transferohet.

Transferimi tek te tretet mund t'i behet pjeseve te kapitalit themeltar vetem me vendim te ortakut te vetem .

Per cdo rast transferimi kapitaleve apo ndryshimi ne zvoglim apo zmadhim i tij do te behet me Akt Noterjal.

Neni 8

Administrator i Shoqerise eshte Z. Paride Boschetti, me identitetin e mesiperm.

Organ i vetem drejtues eshte ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise : Z. Paride Boschetti.

Kjo shoqeri ka stemen e saj , vulen dhe llogarine rrjedhese te vecante . qe disponohen nga ortaku i vetem dhe administratori i saj.

Kjo Shoqeri fiton personalitetin e saj juridik qe nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar.

Kjo kerkese u hartua ne Tirane sot me date 25. 03. 2002 nga une ortaku i vetem Paride Boschetti.

Paride Boschetti

Neni 9

### **KONTRIBUTET DHE FITIMI**

Kontributet i takojne ortakut te vetem .Ne rast ndryshimi te ortakerise ndryshojne edhe kontributet dhe ne konformitet me kete raport ndyshimesh percaktohet edhe raporti i fitimit.

Neni 10

### **KREU III**

#### **MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE**

Vetem Ortaku i vetem dhe administratori sipas limiteve ligjore ka te drejte te perfaqesoje shoqerine. Ai mund te emerrojne edhe perfaqesues ,drejtues tekniko organizativ apo avokat sipas normave te perfaqsimi, te parashikuara ne Kodin Civil dhe ate te Procedures Civile.

Neni 11

#### **ADMINISTRATORI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

Shoqerija administrohet nga nje ose disa administratore, qe duhet te jene persona fizike ose jo.

Administratoret emrohen dhe shkarkohen nga ortaku i vetem .Administratori ne mardhenje me ortaket dhe te tretet ka te gjitha kopetencat per kryerjen e te gjithveprimeve administruese ne interes te Shoqerise dhe ne emer te saj, nepermjet akteve qe perputhen me objektin e shoqerise, me perjashtim te kopetencave qe ligji dhe statuti ja jep shprehimisht ortakut te vetem.

Per drejtimin teknik te shoqerise meqe eshte nje shoqeri me karakter inxhinieriko gjeo topografi ne baze te kerkesave ligjore do te emerohet nje drejtues teknik me license ,i cili ka pergjegjesine teknike dhe ligjore sipas ligjeve dhe normave ne fuqi per te gjithve punimet qe ndermerr kjo shoqeri.

Administratores apo drejtueset teknik, jane pergjegjes ndaj shoqerise apo ndaj te treteve si per shkeljet ligjore ashtu edhe per shkeljet e Statutit, ose per mangesi ne administrim per faj te tyre. Gjithmone pergjegjesite jane personale ne funksion te detyrave qe ushtrojne. Asnje Kontrate Punesimi apo detyrimesh te tjera nuk ka fuqi pa keto percaktime.

Shoqerija nuk mer persiper asnje detyrim ndaj te treteve, per deme te shkaktuara nga aktet e veprimet e Administratorit apo drejtuesit teknik ,me tejkalime nga objekti i kesaj Shoqerije ose shkeljet e lartepemendura. Perkundrazi kufizimet me Statut te kopetencave te administratorit duhen marre ne konsiderate nga te tretet.

#### Neni 12

Marveshja e administratorit per probleme te Statutit dhe Kapitalit Themeltar, nuk pranohen nga ortakut i vetem , nese ajo mareveshje nuk i eshte parashtruar ortakut te vetem kur detyra e ortakut te vetem nuk eshte njehesuar tek njejt person qe posedon detyren e administratorit

#### Neni 13

Administratorit , apo cdo perfaqesuesi tjetet te Shoqerise u ndalohe perpilimi i Kontratave jashte vendimeve te ortakut te vetem, per paradhenje, dorzani apo angazhime te ngjashme me to, ndaj te treteve.

#### Neni 14

Administratori dhe drejtuesi teknik ,ka pergjegjesi civile dhe penale per shkeljet ligjore. Ne kete rast Kerkese Padija ngrihet nga ortakut i vetem dhe nuk mund te kufizohet me kete Statut.

Shkarkimi nga detyra e Administratorit apo drejtuesit teknik behet me vendim te ortakut te vetem.

### KREU IV

#### ORTAKU I VETEM

#### Neni 15

Ortakut i vetem eshte organi qe ka te drejte te emeruje dhe shkarkoje administratorin , drejtues teknik, eksperte kontabel apo te autorizuar si dhe likuidues, miraton raportet e administrimit dhe kontrollit, llogarite vjetore, ndryshimet ne statut, zvoglim apo zmadhim si dhe transferim te kapitalit themeltar si thame me lart, zgjat ose shkurton kohen e veprimtarise se shoqerise ose likuidimin e saj, shnedrimin e sh.p.k. ne shoqeri te formave te tjera. Po keshtu detyra te vecanta ka ne perpilimin dhe miratimin e preventivave dhe situacioneve te paraqitura nga drejtuesi teknik. Ky i fundit nuk mund te miratoj tek te tretet dokumentacione tekniko ekonomike pa konsensusin e shprehur te administratorit.

#### Neni 16

Ortaku i vetem i Shoqerise, ka te drejta te plota per pjesmarrjen ne fitime, kontribute ne Shoqeri si dhe administrimin e saj ne perputhje me ligjet, dhe Statutin e kesaj Shoqerije.

Ai pergjigjet per parregullsine e themelimit te Shoqerise dhe ndryshimeve ne Statut, per humbjet e Shoqerise deri ne kufirin e kontributeve respektive ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise.

#### Neni 17

Raporti i administratorit, drejtuesit teknik, inventaret, bilancet dhe llogarite vjetore hartohen nga administratoret dhe drejtuesi teknik dhe i paraqiten ortakut te vetem, brenda 2 muajve nga mbyllja e vitit financiar, i cili vendos per miratimin e tyre.

Ortaku i vetem ka te drejte te marre dhe ekspertoje ne vecanti cdo dokument te mesiperem per gjithe periudhen e aktivitetit te Shoqerise.

### **KREU I V**

#### **EKSPERTET KONTABEL DHE ATA TE AUTORIZUAR**

#### Neni 18

Ne rast nevojje ose sipas kerkesave te ligjes, kontrolli i Shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar ose emruar si dhe eksperte ne fushen e ndertimeve.

Emrimi i Eksperteve Kontabel te Autorizuar dhe drejtuesve teknik behet me vendim te Ortakut e vetem dhe kur e do ligja me akt noterial.

#### Neni 19

Caktimi dhe aktiviteti i ekspertit kontabel te autorizuar dhe drejtuesit teknik eshte kufizuar nga ligjet specifike si dhe pasqyrimi ne kete Statut.

Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar dhe drejtuesit teknik, vendoset ne te njejtat kondita si emrimi, nga ortaku i vetem, nese vihen re gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

### **KREU VI**

#### **VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE DHE NXJERRJA E FITIMIT**

#### Neni 20

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret, drejtuesit teknik dhe nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen sipas nenit 17 te ketij Statuti.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore ekonomiko financiare behen brenda nje afati tre mujor nga data e mbylljes se vitit financiar, sipas percaktimit te Zyres se Tatim Taksave.

#### Neni 21

Fitimi qe rezulton pas miratimit te llogarive vjetore dhe percaktimit te tij jane prone ekskluzive e ortakut te vetem sipas nenit 7 te ketije Statuti. Nga ky fitim riinvestohen shuma dhe percaktohen fondet rezerve sipas deshires se ortakut te vetem ne konformitet me nenet e sipertreguara te ketij Statuti.

Fitimi duhet te rezultoje i paster dhe pas nje analize serioze te aktivitetit financiar nje vjecar, duke zbritur humbjet dhe detyrimet ndaj te treteve si dhe ballafaquar me rezultatet e viteve te mepareshme.

## **KREU VII**

### **ZGJATJA E AFATIT ,PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

#### **Neni 22**

Ne perfundim te afatit te percaktuar ne nenin 5 te ketij statuti, zgjatja e tij vendoset nga ortaku i vetem .

Shoqerija prishet ne perfundim te afatit te pecaktuar ne nenin 5 te ketij statuti me perjashtim te rasteve ku behet zgjatja e afateve sipas ketij neni ose kur ka nje prishje te parakoheshme per aresye te parashikuara me ligj.

#### **Neni 23**

Me falimentimin ose vdekjen e ortakut te vetem shoqerija falimenton. Kur humbjet kalojne gjysmen e Kapitalit Themeltar, mund te shpallet falimentimi. Inisiativa per marrjen e nje vendimi ne keto kushte i takon ortakut te vetem ne Shoqeri, dhe me kerkese gjykata vendos per prishjen e Shoqerise.

#### **Neni 24**

### **LIKUIDIMI I SHOQERISE**

Shoqerija hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi, Ortaku i vetem emron nje ose disa likuidues, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likuidimit Ortaku i vetem vendos, mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullushmerise se punes se likuiduesit, dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjeve te pjeseve te kapitalit themeltar (nese ka tjetersuar pjese) tek kontribuesit perkates, likuiduesi evdenton mbetjen ne pronesi te ortakut te vetem te Shoqerise.

## **KREU VIII**

### **DISPOZITA TE FUNDIT**

#### **Neni 25**

### **SHNDRIMI I SHOQERISE**

Shndrimi i kesaj shoqerije (sh.p.k.) ne shoqeri kolektive ose shoqeri komandite, ose anonime, mund te kryhet me miratimin e Ortakut te vetem, nepermjet ekspertit te posacem per shndrimin.

Neni 26

#### **MOSMARREVESHJET**

Te gjitha mosmareveshjet qe mund te lindin gjate egzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit, ndermjet shoqerise dhe te treteve ose ortakut te vetem dhe te treteve do t'i paraqiten per zgjidhje Gjykates se Rrethit Tirane.

Neni 27

#### **VULA ,STEMA DHE LLOGARIJA RRJEDHESE**

Kjo shoqeri ka stemen e saj , vulen dhe llogarine mjedhese te vecante , qe disponohen nga ortaku i vetem .

Neni 28

Kjo Shoqeri fiton personalitetin e saj juridik qe nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar.

Neni 39

Ky statut u hartua ne Tirane sot me date 25 Mars 2002 nga ortaku i vetem , zoti Paride Boschetti dhe u perpitua ne pese kopje ne mbeshtetje te ligjeve ne fuqi per kete qellim.

**ORTAKU I VETEM**

Paride Boschetti

